

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni civil si gjykatë e shkallës së parë e përbërë nga gjyqtari Binak Duqi me sekretaren juridike Xhevide Selmani, ne çështjen juridike të paditësve: A.F. nga fshati S. dhe A. Ll. nga fshati S. Komuna e P., të cilit i përfaqëson Z. I. avokat nga P. me autorizim, kundër të paditurës KS “I.” nga Prishtinë të cilën e përfaqëson D. K. me autorizim, për kompensim demi, në seancën publike në praninë e të autorizuarit të paditësve dhe përfaqësuesit të paditurës me dt. 27.08.2013, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditëses: A. F. nga fshati S. dhe A. Ll. nga fshati S. Komuna e P., si e Bazuar , dhe **DETYROHET** e paditura KS “I.” nga P., që paditësve për shkak të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut me dt. 28.11.2006, në rrugën Magjistrale Prishtinë- Podujevë, të ju paguaj:

Paditësit A. F.

Në emër të dëmit jo material:

Për shkak të dhimbjeve fizike shumën prej 800 €,

Për shkak të frikës së përjetuar shumën prej 850 €.

Në emër të dëmit material

Për shkak të dëmtimit të automjetit “VW Pasat “ me targa të regjistrimit *numër i targave...*, shumën prej 413.50 €.

Gjithsejtë shuma për pagesë për paditësin për dëmin jo material dhe material është 2065,50 €, përtej shumes së aprovuar shuma prej 990.50 €, **Refuzohet si e pabazuar.**

Paditësit A. Ll.

Në emër të dëmit jo material për shkak të dhimbjeve fizike shumën prej 800 €.

Për shkak të frikës së përjetuar shumën prej 850 €.

Gjithsejtë shuma e aprovuar për paditësin është 1650 €.

Përtej shumes së aprovuar për paditësin prej 1650 €, shuma prej 850 € refuzohet si e pabazuar.

Gjithsejtë shuma e aprovuar për të dy paditësit është 3715.50 €, e të gjitha këto shuma obligohet paditura që të i paguaj me kamat paditësve si që e paguajnë bankat afariste në Kosovë , për mjete të deponuara mbi 1 vit, pa destinim të caktuar duke filluar prej dt. 24.11.2009, gjer në pagesën përfundimtare në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Detyrohet e paditura që paditësve tua paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 830 €, në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit në padi dhe seancat e mbajtura në gjykatë nëpërmes të autorizuarit të tyre avokatit Z. I. kanë theksuar se me dt. 28.11.2006, ka ndodhë aksidenti i komunikacionit në rrugën magjistrale Prishtinë- Podujevë, në fshatin Lebanë me që rast në këtë aksident kanë qenë të involvuara veturat VW Pasat, me targa regjistrimi *numër i targave...*, të cilën e ka drejtua paditësi A. F. , vetura opell vektra me targa regjistrimit *numër i targave...*, të cilën e drejtonte S. J. si dhe veturës Pasat me targa *numër i targave...*të cilën e drejtonte A. R.. Aksidenti ka ndodhur në rastin deri sa veturën Opell Vektra e kishte ndaluar patrulla e policisë dhe në atë rast vjen vetura Pasat me targa *numër i targave...*, e duke mos iu përshtatur shpejtësisë së lëvizjes së automjetit dhe kushteve në rrugë vozitësi nuk ka mund të ndalë automjetin e tij dhe me pjesën e përparme të automjetit e ka goditur në pjesën e prapme veturën opell vektra dhe nga përplasja ky automjet në pjesën e përparme e ka goditur në pjesën e mbrapse automjetin e tipit VW Pasat me targa *numër i targave...*, të cilin e drejtonte A. F..

Paditësit si A.F. ashtu edhe A. Ll. janë paraqitur në QKMF Podujevë, pas aksidentit me dt. 28.11.2006. çka i kanë ofruar gjykatës edhe raportet mjekësore të tyre.

Paditësi A. Ll. ka qenë si bashkudhëtarë dhe kjo vërtetohet se i njëjti ka pësuar lëndime nga raporti mjekësor i QKMF .

Mbi bazën e këtyre fakteve të paraqitura i autorizuari i paditësve i propozon gjykatës që ta detyrojë të paditurën tua kompensoj dëmin jo material dhe material sipas bazës së auto përgjegjësisë dhe atë për paditësit A.F. kërkon shumën prej 1500 € për dhimbjet fizike , dhe 1000 € për frikën e përjetuar. Kurse për dëmin material për automjetin e dëmtuar pasat me targa të regjistrimit *numër i targave...*, e kërkon shumën prej 413.50 €, Sa i përket paditësit A. Ll. i autorizuari për kompensim kërkon në emër të dëmit jo material për dhimbjet fizike të shkaktuara shumën prej 1500 €, kurse për frikën e përjetuar shumën prej 1000 €, e të gjitha këto me kamat duke fillua prej dt. 24.11.2009, Shpenzimet e procedurës i kërkon sipas TA, dhe atë për shqyrtimin paraprak C.nr.61/2007, dhe shqyrtimi ne tanishëm gjithsejtë 990 €.

I autorizuari i të paditurës D. K. në përgjigjeje në padi, gjatë seancave dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar se e konteston pjesërisht kërkesëpadinë sa i përket lartësisë për A. F. por nuk e konteston bazën juridike për te. Kurse sa i përket paditësit A. Ll. e ka kontestuar në tërësi bazën juridike dhe lartësinë e dëmit sepse i njëjti nuk figuron në raportin e policisë si pasagjer apo vozitës.

Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj.

Gjykata për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore në procedurën e provave bëri administrimin dhe leximin e këtyre provave si : aktvendimin e gjykatës për kundërvajtje me nr. Regj.nr.6299/2006-2, dt. 21.12.2006.

Raporti i policisë me nr. 06-AR-01777, dhe 0601-7550 të dt. 28.11.2006, u lexua raporti nga emergjenca në QKMF Podujevë nr. 437 dt. 28.11.2006, ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Y. K., dt. 31.01.2008, ekspertiza mbi vlerësimi ne dëmit material për automjetin e dëmtuar të paditësit A.F. i dt. 21.01.2008, mendimi i ekspertëve mjekoligjorë për lëndimet e pësuar të paditësve në aksident të dt. 12.05.2009, si dhe raportet e QKMF Podujevë për paditësin A. F. me nr. Protokollit 437 si dhe për paditësin A. Ll. me nr. Protokollit 438 t dt. 28.11.2006. si dhe u lexua fotokopja e librit të QKMF për pacientët e lajmëruar në shtëpinë e shëndetit në Podujevë.

Pas vlerësimit të provave një nga një e të gjitha së bashku konformë nenit 8 të LPK gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike në këtë çështje kontestimore.

Se kërkesëpadia e paditësve A. F. dhe A.LI. është pjesërisht e bazuar dhe si të tillë e aprovoi.

Është jo kontestuese në këtë çështje kontestimore baza juridike për paditësin Armend Fejzullahun se i njëjti ka pësuar në aksident lëndime të lehta trupore dhe dëmtimin në automjetin ed tij. Kjo vërtetohet nga raporti i policisë me nr. 06-AR-01777 dhe 06-01-7550, të dt. 28.11.2006, ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Y. K., mendimit të ekspertit mjekësor dr. A.T., ortoped dhe mendimi i ekspertës së psikijatris dr. N. M. , ekspertiza e ekspertit të makinerisë për makinën e dëmtuar në aksident N. Sh. të dt. 21.01.2008, aktvendimit të Gjykatës Komonale për Kundërvajtje në Podujevë me dt. 6299/2006-2 dt. 21.12.2006, raportet mjekësore mirëpo nuk e ka kontestuar bazën juridike as e paditura.

Pjesërisht u kontestua lartësia e dëmit nga e paditura për këtë paditës dhe gjykata pati parasysh kundërshtimet e të paditurës duke vlerësuar se ka të drejtë andaj i aprovoi shumat si që janë në dispozitiv të këtij aktgjykimi, kurse i refuzoi shumat e precizuar nga pala paditëse si tejet të larta dhe jo në harmoni me praktiken gjyqësore , kriteret e KS si dhe LMD neni 200 al.1. dhe 2 .

Po ashtu gjykata e aprovoi shumën për dëmin material në automjetin e paditësit A. F. në shumën prej 413.50 €, e jo vlerësimin e ekspertit i cili ka llogaritur orën e punës gabimisht nga 17.50 € orën e punës e jo 8 € që duhet të jetë, andaj eksperti e ka llogaritur shumën e dëmit material prej 556 € mirëpo kjo duhet të jetë 413.50 €, si që është pajtuar dhe vet i autorizuari i paditësve duke bërë përmasimi ne gabimit në vlerësim të orëve. Në procesverbalin e shqyrtimit të mëparshëm C.nr.61/07, të Gjykatës Komonale në Podujevë dt. 24.11.2009.

Në shqyrtimin kryesor me që rast ka bërë edhe precizimin e kërkesëpadisë.

Aksidenti është shkaktuar me fajin ekskluziv të siguruarit të paditurës A. R. ne automjetin e tij Pasat me targa *numër i targave...*, i siguar tek paditura kurse në këtë aksident nuk kanë kontribuar fare pjesëmarrësit tjerë me automjetet “Opell vektra” me targa *numër i targave...dhe automjeti”Pasat” numër i targave...që* e ka vozitë ngasësi – paditësi A. F.. Po shkaktar i këti aksidenti është vozitësi A. R. kurse dy vozitësit tjerë nuk kanë kontribuar fare në aksident të cilit kanë qenë detyrimisht të ndalur. Kjo u vërtetua nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Y. K. me dt. 31.01.2008, raporti i policisë dhe aktvendimi i Gjykatës Komonale për Kundërvajtje në Podujevë me nr. Regj. 6299/06-2, dt. 21.12.2006, mirëpo kjo u pranua në një mënyrë nga vetë e paditura .

Sa i përket lëndimeve dhe frikës së paditësit ajo u vlerësua nga ekspertët mjekoligjorë dr. A. T. ortoped dhe dr. N. M. psikiatër në mendimin e tyre të dhënë me dt. 12.09.2009, dhe ata i kanë kualifikuar lëndimet e tij për paditësin A. F. si lëndime të lehta trupore.

Përgjegjësia e të paditurës rrjedh nga baza e auto përgjegjësisë së të paditurës sepse i siguruari i saj kishte automjetin e tij pasat me targa *numër i targave...*, të siguar tek paditura me nr. Police 0000444089 me validitet deri me 05.04.2007, por përgjegjësia rrjedh edhe nga rregulli tre i BQK.

Andaj gjykata duke u nisur nga kjo gjendje për paditësin e lartpërmendur i aprovoi shumat prej 800 € për dhimbje fizike dhe 850 € për frikën e përjetuar si dhe shumën prej 413.50 € për dëmin material të shkaktuar në automjetin e dëmtuar në aksident.

Mirëpo i refuzoi shumat tjera të kërkuara nga precizimi i bërë si të pabazuara dhe jo në harmoni me kriteret e Kompanive të Sigurimeve, praktik Gjyqësore, LMD mirëpo gjykata pati parasysh edhe kundërshtimet e të paditurës në këtë rast. Sa i përket ekspertizës së ekspertit të komunikacionit Y. K., gjykata mendon se është mjaft profesionale dhe e bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Për paditësin A. Ll. e paditura e ka kontestuar bazën juridike dhe lartësinë e dëmit mirëpo sipas gjykatës e paditura nuk ka të drejtë në kundërshtimet e sajë.

Sepse nga vërejtjet e gjykatës së qarkut në Prishtinë me aktvendimin e saj Ac.nr.72/10, dt. 25.10.2012, nuk është përmendur fare mungesa e bazës juridike për paditësin e dytë A. Ll. dhe në këtë pikë është vërtetuar mendimi i gjykatës Komunale në Podujevë. E paditura gjatë tërë shqyrtimit dhe në seanca të mëparshme C.nr.61/2007,. Nuk e ka kontestua asnjëherë bazën juridike për paditësin mirëpo të njëjtin nuk e ka kontestua as kur ka bërë ankesë kundër aktgjykimit të kësaj gjykate. Andaj kjo pikë nuk është objekt shqyrtimi edhe pse tani e ka kundërshtua në shqyrtim e paditura C.nr.492/12.

Mirëpo edhe përkundër kundërshtimeve të paditurës për paditësin A. Ll. dhe kontestimit të bazës juridike duke theksuar se i njëjti nuk ka qenë i përfshirë në aksident dhe se nuk figuron në raportin e policisë gjykata mendon se përpos që nuk është kontestuar baza juridike nga shqyrtimi i mëparshëm në kontestin e mëparshëm C.nr.61/2007, as nga parashtrësia e të paditurës me dt. 24.11.2009, me nr. 1768 mirëpo as me rastin e ankesës së ushtruar kundër vendimit të Gjykatës Komunale Podujevës, me të cilin është aprovua kërkesëpadia e paditësve por e njëjta nuk është kontestuar dhe nga gjykata e Qarkut në Prishtinë, por në këtë çështje vërtetohet sepse nga provat mjekësore shefet se paditësi A. Ll. është lajmëruar tek specialisti me nr. Protokoli 720/2006, dt. 30.11.2006, po ashtu nga raporti i QKMF Podujevë që gjendet emri i shenuar për paditësin me nr. Protokoli 438 dt. 28.11.2006, librit të regjistruarave si pacient në QKMF Podujevë që është lajmëruar paditësi për vizitë mjekësore po ashtu me nr. Rendor 438 (fotokopja e sajë) gjykata mendon se i njëjti ka qenë si bashkudhëtarë në automjet me paditësin tjetër A. F. në automjetin e tij me targa të regjistrimit *numër i targave...*, të tipit Pasat . bindja e gjykatës forcohet edhe më tepër pas mendimit të dhënë të ekspertëve mjekoligjor dr. A. T., ortoped dhe dr. N. M. psikiatër ku kanë konstatuar lëndimet e paditësit nga aksidenti të cilat janë kualifikuar si lëndime të lehta trupore me dhembje fizike të intensiteti të rëndë 1 ditë, atij të mesëm 10 ditë dhe të ulët 3 javë , frikë të intensitetit të lartë tri ditë dhe frikë të intensitetit të ulët 1 muaj, ka pas nevojë për ushqim të përforcuar për 10 ditë.

Nisur nga kjo gjendje dhe mos kundërshtimi i bazës juridike në procedurën e shqyrtimit të mëparshëm C.nr.61/07 duke mos e kundërshtuar e paditura as me paraqitjen e ankesës as parashtrësën e saj drejtuar gjykatës , gjykata është e mendimit se kundërshtimet e të paditurës janë të pabazuara fare. Sepse provat flasin ndryshe.

Ishte i bazuar kontestimi i lartësisë së dëmit pjesërisht sepse shuma e aprovuar është e lartë krahasuar me lëndimet , llojit dhe natyrën e tyre si dhe zgjatja e dhimbjeve dhe frika e përjetuar.

Andaj, gjykata i aprovoi 800 € kompensim dëmi jo material për dhimbje fizike dhe 850 € për frikën e përjetuar duke menduar se shuma e tillë është satisfakcion real me lëndimet e pësuar të paditësit dhe të mirën e dëmtuar në aksident.

Aprovimi i shumave për kompensim të paditësve si që është cekur në dispozitiv të aktgjykimit gjykata mendon se është në harmoni me nenin 200 al.1. dhe 2 të LMD me të cilin kërkohet kompensimi të jetë sa më i drejtë , i baraspeshuar me humbjet e pësuar

dhe të mirën e shkelur të paditësve qëllimin që u shërben ky kompensim duke mos shkuar përshtati synimeve të tyre për pasurim të pa bazë dhe të dëmtimit të palës së paditur por që ato të jenë të pajtueshme me natyrën e saja dhe qëllimin shoqërorë. Këto shuma të aprovuara janë në pajtim dhe me kriteret e kompanive të sigurimeve të miratuara nga ato, praktiken gjyqësore dhe rregullin 3 të BQK. Shumat e aprovuara gjykata i ka bazuar dhe në nenet 154,155,173,174 dhe 200 të LMD, ekspertizën e ekspertit të komunikacionit Y. K. , mendimi i ekspertëve mjekoligjorë të ortopedisë dhe psikiatrisë si lëndime mjaft profesionale dhe në kuadër të etikës mjekësore, mendimit të ekspertit të makinerisë si dhe provat tjera të ofruara nga raportet mjekësore posaçërisht nga paditësi A. Ll.. Të cilat janë nga QKMF Podujevë.

Gjykata murr parasysh kundërshtimet e të paditurës sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë për paditësin dhe të njëjtat i aprovoi pjesërisht si që janë shumat e aprovuara në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore gjykata ato i aprovoi pjesërisht konformë suksesit të palës paditëse në kontest dhe atë 530 € nga shqyrtimi i më hershëm në lëndën kontestimore C.nr.61/2007, duke përfshirë edhe taksën gjyqësore në këtë shumë , prej 50 €, dhe atë 25 për padi dhe 25 për aktgjykim si dhe ekspertizat kurse për shqyrtimin e tanishëm në lëndën C.nr.492.12, ju aprovuan shpenzimet për dy shqyrtime nga 150 €, e që bëjnë 300 €, gjithsejtë shuma e aprovuar të shpenzimeve të procedurës konstatimore është 830 €, kurse shuma e refuzuar është 160 €, si e pabazuar.

E tëra kjo u vendos konformë neneve 449 al.1. dhe 2 , 450 , 451.1 dhe 452.2 të LPK-së. Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË- DEGA PODUJEVË
C.nr.492/12. të dt.27.08.2013.

Gjyqtari:
Binak Duqi

KESHILLA JURIDIKE;

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar
Ankesa në afatin prej 15 ditësh, prej ditës
së marrjes së një kopje Gjykatës së Apelit
Prishtinë, përmes kësaj gjykate.